



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E SUHAREKËS

MUNICIPALITY OF SUHAREKA

30.01.2022

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARRE NË DORËZIM - PRILJENO RECEIVED			
Nëse orig. Orig. Unit	Numri Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	052	7048	7

Drejtoria për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë

Për:	Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Enver Shabani, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë
Lënda:	Raporti i muajit Janar 01.01.2023-31.01.2023
Protokoll	
Datë:	31.01.2023

Në bazë të urdhërësës së Kryetarit mbi raportin e punës, gjatë muajit shtator **01.01.2023-31.01.2023**, ku gjatë kësaj periudhe kemi punuar si më poshtë :

Spektori i Shërbimeve publike

Në koordinim me zyrtarët e drejtorisë , gjatë muajit janar kemi pranuar 23 lëndë të reja nga palët, dhe kemi kthyer dhjet (10) përgjigje. Gjithashtu kemi pasur takime verbale me qytetarët e Komunës tonë ku kanë pasur kërkesa të ndryshme, ku disa nga ta kemi dalur edhe në teren i kemi vizituar për të parë nga afër shqetësimet e tyre.

Po ashtu kemi pranuar fatura të ujit, rrymës, telefonit, mbeturinave, projekteve të ndryshme, si dhe shumë faturave të komunës. Përgaditja e kërkesave të KEDS-it për pëlqimet konkrete të tyre si dhe pëlqimeve të qytetarëve, kërkesa të shpeshta në KEDS, për vendosjen e njësorëve të rrymës si dhe shumë kërkesa të ndryshme sipas nevojës së Komunës.

Mirëmbajtja dhe pastrimi i qytetit

Në kaudër të projektit mirëmbajtja dhe pastrimi i qytetit, gjatë këtij muaji janë kryer këto shërbime: pastrimi i rrugëve lokale, mirëmbajtja e hapësirave publike, pastrimi i hapësirave të varrezat e qytetit, pastrimi dhe mirëmbajtja e qytetit tek sheshi Fadil Vata, pastrimi i promenades si dhe pyellit, tek gjimnazi, pastrimi i parkut të qytetit.

Mirëmbajtja dhe Pastrimi i Rrugëve Lokale nga bora

27.01.2023, Ne bazë të kontratës mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve nga Bora. Menaxheri i kontratës ka dalur në hospitium të rrugëve, ku kompania ka bërë pastrimin dhe hedhjen e kripës në relacionin: Shirokë-Suharekë-Reqan-Mohlan-Papaz (ku nga këtu është intervenuar)-Grejçevc (Lagjia Bungu, Reshani deri tek Xhamia).



Me 10.01.2022, kemi pasur takim me përfaqësuesit e JICA-s, dhe DKA lidhur me marrëveshjen për piken 1 të pilotprojekteve, ku në këtë takim ishte edhe pronari i kompanisë Pista, ku u dakorduam që kjo kompani ta bëjë mbledhjen e kapakave të shisheve.

11.01.2022, kemi pasur takim online me z. Paulo lidhur me progresin e projektit të PP4 për taksën komunale, ku u diskutua për

- * Kontrata me ekoregjonin lidhur me shërbimin dhe inkasimin nga ana e jonë,
- * Marrëveshje Komune-Ekoregjion për bartjen e të dhënave të klienteles,
- * Si dhe progresin e këtij projekti,

Me datë 20.01.2023, kemi pasur takim me znj. Valtida Shukriun për projektin PP4, ku Valtida na ka ndihmuar për progresin e Rregullorës Komunale për menaxhimin e mbeturinave, ku deri me datë 25.01.2022, e kemi pasur në diskutim publik (për verejtje dhe rekomandime nga ana e qytetarëve).

Po ashtu, jemi në koordinimin me zyrën ligjore lidhur me PKMM dhe Rregulloren Komunale për procedim në Asamble Komunale.

Inspektori I preventives së Zjarrit

Gjatë muajit Janar janë kryer punë në bazë të Planit vjetor të punës, si dhe punë tjera administrative dhe punë në teren sipas kërkesave të palëve.

Janë bërë pesë inspektime të rregullta të objekteve dhe dy inspektime kontrolluese.

Është bërë inspektimi i objektit të shkollës fillore Hasan Prishtina në Semetisht, objektit hotelier Estrada në Grejkoc, si dhe disa dyqaneve.

Poashtu gjatë këtij muaji kemi lëshuar një Pëlqim në dokumentacionin investivo-teknik për një objekt në Mushtisht, si dhe kemi dalë në teren për të verifikuar dëmet e shkaktuara nga një keqësimi i motit nga erërat e fuqishme në Grejkoc dhe Sallagrazhdë.

Sektori për infrastrukturë

Gjatë periudhës mujore: Janar 2023, sipas procedurave ligjore janë përgatitur dokumentacionet për Projektet Kapitale për vitin fiskal 2023. Janë bërë fillimisht sistematizimi i dokumentacionit të vitit paraprak të projekteve, përgatitje të dokumentacioneve si dhe kërkesa dhe Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve për inicim të procedurave për projektet kapitale të vitit fiskal 2023.

Projektet të cilat janë të kontraktuara në vitin: 2020, 2021 dhe 2022 të cilat janë kontrata shumëvjeqare janë duke u menaxhuar nga Drejtoria e Sherbimeve Publike Mjedis dhe Emergjencë dhe punimet janë ndërprerë për shkak të kushteve atmosferike dhe pas krijimit të kushteve atmosferike, punimet vazhdojnë edhe në vitin 2023.

Si dhe është bërë menaxhimi i projekteve të cilat janë: Projekte me Bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës:

- Asfaltimi i rrugës lokale nga kryqezimi i rrugës Nacionale N25-Grejkoc -Rrafshi i Livadheve
- Ndërtimi i unazës – Krahu i djathtë – Suharekë
- Ndërtimi i rrugës Sopi – Shirokë (Rrethrotillimi Leshan L – 5850 M
- Asfaltimi i rrugës që lidhë fshatin Ngucat (Rruga Bashkim Gashi) - (Lagja Zekolli), Suharekë
- Ndertimi i rruges Mushtisht - Verbeshticë - Shtërpçë

Janë përgatitur projektet për aplikim për Grande Qeveritare gjegjësisht për aplikim në:

- Ministrinë e Zhvillimit Rajonal
- Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal

Gjatë kësaj periudhe është punuar në bashkëpunim me UNDP, në projektin „Fuqizimi i veprimit lokal për klimën”, i cili mbështetet nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), Komuna e Suharekës dhe Komuna e Prizrenit.

Poashtu janë bërë vizita të punimeve të cilat janë duke u zhvilluar në teren si dhe vizita sipas kërkesave të qytetarëve.

Përgatitja e referencave për punët e kryera sipas kontratave, të kërkuara nga Operatorët Ekonomik.

Sektori për Mjedis

Përgjegje në shkresa të ndryshme mjedisore, varësisht nga karakteri i tyre

Përcjellje të proceseve dhe planeve të ndryshme me karakter mjedisor

Përgaditja e Pëlqimeve në parim sipas kërkesave ku është regjistruar 1,

Dalje në teren për lëndë të caktuara

Përcjellja dhe mbikqyrja e disa prej projekteve të ngarkuara me Aktvendim për disa nga projektet kapitale.

Sektori për Emergjencë

Raport i muajit Janar 2023 i Intervenimeve të NjPZSH

Nr. Ren	Nr. Regj.	Data	Emir dhe Mbiemri	Vendlindja	Vendngjarja	Sektori	Intervenimi	Çka është demtuar
01.	01/01	01.01.2023	EKO-Regjioni		Suharekë	Shoqëror	Zjarrë	Mbeturina
02.	02/01	03.01.2023	Esat Abazi	Mushtishtg	Mushtisht	Privat	Zjarrë	Oxhaku I shtëpisë
03.	03/01	11.01.2023	EKO-Regjioni		Suharekë	Shoqëror	Zjarrë	Mbeturina
04.	04/01	12.01.2023	Valon Berisha	Suharekë	Suharekë	Privat	Zjarrë	Oxhaku I shtëpisë
05.	05/01	13.01.2023	Halil Grulaj		Peqan	Privat	Zjarrë	Kulmi I shtëpisë
06.	06/01	18.01.2023	I paidentifikuar		Grejkoc	Privat	Erëra	Nga era 2 kulme dhe 1 serë
07.	07/01	19.01.2023	Urim Hashim Lumi	Bllacë	Bllacë	Privat	Zjarrë	Njehsori elektrik
08.	08/01	19.01.2023	Skenderaj dhe Klinë		Skenderaj dhe Klinë	Shoqërore	Vërshime	Në ndihme, evakuim I familjeve të ngujuara
09.	08/01	28.01.2023	I paidentifikuar		Rrafshi I Sopisë	Privat	Aksident	Pastrimi I rrugës nga mbetjet dhe zhavorri

Ju faleminderit për mirëkuptim!



Sinqerisht !

DREJTORI :
Enver Shabani